



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 qershor 2017, në mbledhjen e XLI - të (dyzetënjtë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Ejup Visoka, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Mrika Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Kumrie Hoti, theksoi, unë kam vërejtje lidhur me rendin e propozuar të ditës ngase në kërkesë timen është miratuar në Plan të punës të Kuvendit që në gjashtëmujorin e parë të këtij viti të shqyrtohet edhe Informata rreth shëndetësisë, Informatë të cilën e kam kërkuar që nga fillimi i këtij mandati përkatësisht katër vitet e fundit, mirëpo e njëjta asnjëherë nuk është propozuar për shqyrtim në Kuvend, kjo është arsyeja që nuk pajtohem me rendin e propozuar të ditës dhe kërkoj që kjo çështje të përfshihet në rend dite ose të jepet sqarim përse nuk përgatitet kjo informatë.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, çështja të cilën e ngriti parafolësja është përfshirë në Planin e punës të Kuvendit dhe është paraparë që Informata e cekur të shqyrtohet në muajin e tetë apo të nëntë të këtij viti në mënyrë që të merren të dhënat përkatëse për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sipas Planit të punës të Kuvendit është e paraparë edhe një mbledhje në muajin korrik por edhe në shtator, para fillimit të fushatës për zgjedhje lokale, jemi të obliguar të mbajmë një mbledhje për miratimin e

projektbuxhetit për vitin 2018, andaj të gjitha materialet e planifikuara dhe materialet e nevojshme mund t'i shqyrtojmë në këto mbledhje.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash përkatësisht 9 vota për dhe një votë kundër.

2. Miratimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 2 maj 2017 dhe 25 maj 2017

Ekstraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Podujevës 2018 – 2020

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, njoftoi se z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, për shkak të mungesës së arsyeshme nuk është i pranishëm në këtë mbledhje mirëpo atë e zëvendëson z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

z. Faik Muçiqi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, i dëgjuam sqarimet e drejtorit z. Faik Muçiqi, nuk kam asgjë të veçantë andaj propozoj që Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për të mos i përsëritur diskutimet, mendimi im është që kjo çështje t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe në mbledhjen e Kuvendit të diskutohet në detaje.

z. Haki Rudari, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore, për ne LVV-në, është dokument shumë i rëndësishëm, dokument me të cilën përcaktohen kahjet e zhvillimit të Komunës për tri vitet e ardhshme, mirëpo edhe pas miratimit të projekteve prioritare po ka devijime të shumta dhe përfshirje të projekteve të reja, kjo dëshkohet nëse i shikojmë Kornizat Afatmesme Buxhetore të mëhershme dhe për këtë subjekti i jonë politikë ka vërejtje.

Në dokumentin për të cilin jemi duke debatuar, te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit përkatësisht për projektin, ndërtimi i bulavardit dhe Sheshit të Dëshmorëve, për këtë vit i kemi pas të planifikuara afro 950.000 € dhe këto mjete pastaj janë propozuar të ridestinohen në 20 projekte tjera, andaj Ekzekutivi i Komunës duhet të ketë kujdes që projektet të mos përfshihen vetëm formalisht që të mbulohen shuma të caktuara buxhetore mirëpo të propozohen projekte të cilat do të realizohen.

Kam edhe vërejtje për projekte të tjera të cilat më gjerësisht do t'i paraqes në mbledhjen e Kuvendit.

z. Islam Revuçi, theksoi, para dy viteve në kuadër të projekteve prioritare ka qenë edhe projekti, asfaltimi i rrugës Bradash – Dobratin, segmenti i lagjes Revuçë, mirëpo ky projekt është hequr për shkak të mungesës së projektit për zbatimin e punimeve, mirëpo tani sipas këtij dokumenti nuk figuron as në periudhën e ardhshme trevjeçare. Projekti në fjalë, në atë kohë, nuk ka qenë i përfshirë në insistim të askujt por nga Drejtoria përkatëse është vlerësuar si projekt i rëndësishëm që realisht edhe është për shkak të gjendjes së asaj rruge. Nuk jam në dijeni për arsyet përse është hequr ky

projekt, mirëpo propozoj që i njëjti të përfshihet në kuadër të projekteve prioritare për vitin 2018.

z. Naim Çunaku, theksoi, në bazë të takimeve me qytetarë jemi dëshmitarë që janë paraqitur disa nevoja të komuniteteve të mjediseve të caktuara të ish Bashkësisë Lokale të Lluzhanit, në veçanti është shtruar nevoja shumë urgjente që të intervenohet në objektin e shkollës së fshatit Llugë, objekt i cili është në gjendje jo të mirë për të mos thënë gjendja është alarmante, kjo është kërkesë në takimet me qytetarë radhazi në katër vitet e fundit, mirëpo për çudi deri tash nuk është përfshirë në kuadër të projekteve prioritare e as në Kornizën Afatmesme Buxhetore të cilën jemi duke e shqyrtuar.

Jam i mendimit se do të ishte shumë e arsyeshme të merret në konsideratë kërkesa e drejtpërdrejt e komunitetit përkatës që ka të bëjë me një fushë sporti, projekt i cili do të realizohej në bashkëpunim të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kur them për këto dy Drejtori e kam parasysh që ajo fushë sporti do të shfrytëzohej nga nxënësit e asaj shkolle por edhe nga komuniteti i lokalitetit përkatës.

Bazuar në këtë propozoj që ai projekt të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2018.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, projektet të cilat i paraqitën dy diskutuesit paraprak janë të arsyeshme dhe propozimi im është që dy Drejtoritë përkatëse t'i shqyrtojnë mundësitë për përfshirjen e atyre projekteve në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2018.

z. Islam Revuçi, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i cili tani erdhi në mbledhje është në dijeni për gjendjen e rrugës Bradash Dobratin në segmentin e lagjes së Revuçëve dhe nevojën për asfaltimin e asaj rruge.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, fillimisht kërkoi falje për vonesë për shkak të zënies me disa punë të tjera zyrtare dhe shtoi, për shkak të ngutisë në përgatitjen e këtij materiali mund të them se është edhe lëshim i imi, projekti të cilin e propozoi z. Islam Revuçi, nuk është përfshirë në këtë dokument por do të propozohet për përfshirje me rastin e miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, nga diskutimet rezulton se dy propozimet e paraqitura janë të qëlluara dhe e kanë mbështetjen e këtij Komiteti, andaj propozoj që Kuvendit t'i rekomandohet që të njëjtat të përfshihen në Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet me plotësim që në Kornizën Afatmesme Buxhetore të përfshihen edhe projektet:

- Asfaltimi i rrugës Bradash – Dobratin (Lagjja e Revuçëve), dhe
- Të shqyrtohen mundësitë që të intervenohet në objektin e SHFMU “ Ilir Konushevci “ në fshatin Llugë, të bëhet përkufizimi dhe rrethoja e oborrit të shkollës dhe ndërtimi i një fushe sportive për nevojat e nxënësve dhe komunitetit të fshatit si dhe vazhdimi i ndërtimit të trotuarit në afërsi të shkollës.

4. Propozim Vendimi për miratimin e përbërjeve të Komiteteve Konsultative

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në cilësinë e kryesuesit të Panelit përzgjedhës për propozimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative, theksoi, Paneli ka punuar në mënyrë shumë të hapur, është përpjekur të bëjë vlerësim sa më real të kandidatëve. Kandidatët për Komitetin për Zhvillim Ekonomik kanë qenë shumë të mirë, pra ka qenë një konkurrencë mjaftë e madhe, mirëpo kandidatët për Komitetin për Shërbime Publike, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë qenë në nivel jo të kënaqshëm.

Fillimisht ne kemi shqyrtuar dhe konstatuar se asnjë prej anëtarëve të Panelit përzgjedhës nuk ka konflikt të interesit, të gjithë anëtarët e Panelit kanë qenë aktiv dhe kanë shtruar pyetje të ndryshme si dhe kemi bërë vlerësime individuale për çdo kandidat veç e veç dhe pas përmbledhjes së pikëve janë propozuar kandidatët të cilët e kanë pasë numrin më të madh të pikëve, propozime të cilat i janë bërë Kuvendit.

Përndryshe, jam i mendimit se kemi bërë përpjekje maksimale që Kuvendit t'i propozojmë kandidatët më të mirë për këto dy komitete.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, për ngritjen e Komiteteve Konsultative kam pasë presione prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe OSBE – së, mirëpo jeni në dijeni se disa herë e kemi publikuar konkursin por nuk janë paraqitur kandidatë, mirëpo tani sipas Udhëzimit Administrativ përkatës anëtarët e Komiteteve Konsultative, për punën e tyre, mund të kompensohen me mëditje në shumë prej 50 € më së shumti për gjashtë mbledhje brenda vitit.

Në sqarimet të cilat i paraqiti z. Faik Muçiqi, ndër të tjera e përmendi se anëtarët e Panelit përzgjedhës nuk kanë pasë konflikt interesi dhe lidhur me këtë them se nuk i kam lejuar të konkurrojnë disa persona me të cilët do të më ndërli dhej konflikti i interesit, pra nuk kam kurrfarë lidhjeje me asnjë prej kandidatëve të propozuar.

z. Rafet Llapashtica, në cilësinë e anëtarit të Panelit përzgjedhës, theksoi, ne anëtarët e Panelit përzgjedhës e kemi bërë intervistimin e të gjithë kandidatëve dhe personalisht jam i bindur se nuk ka pasë kurrfarë dallimesh apo animesh, së paku sa unë kam mundur të vlerësoj. Në dy Komitetet Konsultative përkatëse kanë qenë nga dhjetë apo njëmbëdhjetë kandidatë dhe pasë intervistimit janë përmbledhur rezultatet e poentimit individual të anëtarëve të Panelit, rezultate të cilat në formë të shkruar ju janë dërguar së bashku me materialin e kësaj mbledhjeje.

Lirshëm mund të them se kemi bërë përpjekje të jemi sa më konkret në pyetje dhe sa më real në vlerësimin e përgjigjeve.

Përshtypja ime është se kandidatët kanë treguar përgatitje profesionale, së paku në aspektin e dokumentacionit por edhe të ambicieve, pra gjeneratë e re e cila ka ide që nuk do të thotë se mund të krahasohen me Drejtoritë përkatëse, mirëpo idetë konsultative të tyre sigurisht do të ndikojnë në aspektin pozitiv.

Në fund dua të shtoj edhe këtë se prej kandidatëve të cilët kanë konkurruar jam i bindur se janë përzgjedhur më të mirët, me këtë nuk them se nuk ka ekspert më të mirë se kandidatët e propozuar, mirëpo derisa ata nuk kanë konkurruar nuk kanë mund të propozohen.

z. Fidan Rekalio, theksoi, jam i bindur se Paneli përzgjedhës e ka kryer punën në mënyrën e mirë dhe është propozuar përzgjedhja mbi bazën e përgjigjeve të dhëna nga kandidatët. Pajtohem me parafolësin se mund të ketë ekspert të fushave të ndryshme më të mirë se kandidatët e propozuar, mirëpo derisa ata nuk kanë shprehur interesim për anëtarësim në këto Komitete Konsultative, nuk kanë mundur të përfshihen në këto propozime kur dihet se kjo është çështje që varet nga vullneti personal. Në cilësinë e shefit të Grupit të këshilltarëve të LDK – së e mbështes propozimin e këtij Vendimi.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve i LVV – së, në parim e përkrahim propozimin e këtij Vendimi, mirëpo bazuar në ankesat të cilat kanë arritur në selinë tonë nga përfaqësues të rinisë, ka ankesa në përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre Komiteteve. Unë, me rastin e ngritjes së Panelit përzgjedhës nga ana e Kuvendit, i kam paraqitur vërejtjet e mia lidhur me përbërjen e Panelit përzgjedhës, nga kjo e kam bindjen se në propozimet e paraqitura më tepër ka dominuar ana politike se sa ana profesionale, andaj edhe atëherë edhe tash e them se jam kundër kësaj çështjeje, pra jam kundër që kushdo çoftë të kyçen në Komitete Konsultative vetëm për atë se janë të afërt me parti të ndryshme politike, madje edhe nëse janë të afërt me Vetëvendosjen nuk është mirë të veprohet në atë mënyrë. Po e përsërisë jam për themelimin e Komiteteve Konsultative por që vërtetë të jenë Komitete apolitike dhe tipike profesionale.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk jam në dijeni se cili apo cilët kandidatë janë ankuar në selinë e LVV – së, por këtu është i pranishëm edhe kryesuesi i Panelit përzgjedhës nga i cili kisha kërkuar të mos më lejoj të gaboj edhe pse dallojmë për nga përkatësia partiake përkatësisht jemi anëtarë të subjekteve politike me programe diametralisht të kundërta. Të jeni të bindur se ka pasë kandidatë me titull të magjistraturës të cilët në pyetjet e parashtruara nuk e kanë thënë asnjë fjalë të vetme.

Nëse eventualisht janë ankuar, edhe pse është kundër çdo rregulle mund t'i ftojme dhe të bëjmë intervistimin sërish dhe nëse japin ndonjë përgjigje të kënaqshme, unë personalisht do të kërkoj hetime për punën e Panelit, anëtar i të cilit jam edhe unë.

Në Komisionin e ngritur nga Kuvendi për dhënien e pronës së Komunës në shfrytëzim, PDK nuk e ka asnjë anëtar mirëpo unë plotësisht besoj në punën e atij Komisioni kur në mënyrë të qartë e argumenton çështjet, edhe pse në përbërjen e tij është edhe z. Bahri Selimi, anëtar i LVV – së, andaj në këtë kuptim nuk duhet të kemi dyshime.

z. Faik Muçiqi, theksoi, sipas mendimit tim Paneli përzgjedhës e ka kryer punën në mënyrë profesionale dhe absolutisht nuk është përmendur fare se ndonjë kandidat i përket këtij apo atij subjekti politik, pra nuk ka pasë tendencë partiake.

U përmend se ka pasë ankesa, nëse ka pasë ankesa ato është dashtë të paraqiten në Panelin përzgjedhës e jo te cilido subjekt politik.

z. Haki Rudari, theksoi, u përmend se disa kandidatë nuk janë përgjigjur fare në pyetjet e shtruara, kuptohet se ata nuk kanë mundur të bëhen doktor apo akademik dhe së dyti unë shtroi pyetje, në bazë të cilave kritere janë përzgjedh kandidatët e propozuar.

z. Islam Revuçi, theksoi, për hir të transparencës do të ishte mirë që për kandidatët e propozuar të jepen të dhënat e përgatitjeve të tyre profesionale dhe këto të dhëna të paraqiten në mbledhjen e Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij Vendimi, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Propozim Vendimi për mbështetje financiare Teatrin Publik të Qytetit “ Avdush Hasani “

z. Mrika Taqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, e mbështes propozimin e këtij Vendimi ngase jam i mendimit se duhet të krijohen kushtet dhe mundësitë për aktivitete më të shumta në kuadër të kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne e kemi miratuar Vendimin për themelimin e Teatrit të Qytetit andaj e kemi obligim edhe ta financojmë aktivitetin e këtij teatri, e mbështes propozimin e këtij Vendimi, mirëpo nuk jam në dijeni se sa është e mjaftueshme shuma e propozuar, andaj jam i mendimit se në të ardhmen duhet të shikojmë mundësit për sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm për funksionimin e qëndrueshëm të Teatrit të Qytetit.

z. Haki Rudari, theksoi, natyrisht jemi për ta ndihmuar dhe përkrahur Teatrin e Qytetit, mirëpo unë jam për një teatër tipik profesionist, një teatër i cili e ka përbërjen dhe Bordin profesionist, mirëpo nuk jam në dijeni se Teatri i Qytetit tonë a e ka përbërjen 100% profesioniste apo jo.

Çështja tjetër është se mjetet për këtë qëllim merren nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për kulturë, rini dhe sport, ne jemi të mendimit se jo vetëm kultura por edhe sporti duhet të mbështetet ngase sporti ka ngecur prapa.

Vërejtja ime është se në projeksionet e buxhetit të teatrit për reklama janë propozuar 1.200.00 € dhe për shpenzime të udhëtimit dhe mëditje 2.200.00 € dhe disa shuma të tjera të cilat do duhej të analizohen më mirë. Megjithatë e shfrytëzoj të drejtën e votës së përmbajtur dhe vërejtjet do t'i paraqes në mbledhjen e Kuvendit.

z. Naim Çunaku, theksoi, ne si Komunë e kemi parë të nevojshme që ta kemi një teatër dhe është shumë normale që çdo aktivitet i tij të përcillet me buxhetin përkatës. Më vjen mirë që ky propozim u mbështet nga të gjithë, mirëpo unë pajtohem me z. Rafet Llapashticën se mjetet e propozuara janë shumë simbolike, por ne jemi në një fazë kur ata të cilët zhvillojnë aktivitetet e Teatrit, vet e kanë kërkuar këtë shumë financiare andaj edhe e njëjta duhet të mbështetet.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, nga diskutimet rezultoi se mjetet prej 9.900.00 € nga subvencionet për kulturë rini dhe sport, janë të nevojshme për funksionimin e Teatrit, ndërsa sa i përket menaxhimit të mjeteve përkatëse kjo është e përcaktuar në bazë të përgjegjësive ligjore.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij Vendimi u miratua me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur.

6. Propozim Vendimi për vënien në diskutim publik të ndryshimeve të Planit Rregullues të Hollësishëm – Zona Qendër në Podujevë.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, plotësisht e mbështes propozimin e këtij Vendimi dhe kërkoj nga Drejtoria përkatëse që t'i ftoj qytetarët në debat publik në mënyrë që edhe ata të japin kontributin e tyre dhe mos t'iu servohet diçka e gatshme.

Shfrytëzoj rastin dhe kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që të shqyrtoj mundësitë për sanimin sa më të shpejtë të disa gropave në rrugët e qytetit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i mendimit që kjo çështje t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe në mbledhjet e Kuvendit mund të paraqiten vërejtjet eventuale.

z. Haki Rudari, theksoi, materialin për këtë pikë të rendit të ditës përkatësisht CD – në, e kam marrë një ditë më parë, nuk e kam analizuar në detaje andaj propozoj që propozimi i këtij Vendimi t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit u konstatua se Propozimi i këtij Vendimi, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13.55'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 060/04-0047348/17
Podujevë,
29 qershor 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**